

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Vokshi tregon prapaskenat: Lidhet me konfliktin e Thaçit me Gjermaninë - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/denimi-i-ish-krereve-te-uck-se-analisti-tregon-prapaskenat-lidhet-me-konfliktin-e-thacit-me-gjermanine/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 20:34:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 20:32:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	855610812041938f03beabadb4a6f141d27af49d47d1e81f6994dcb410bea3b4
TEKSTI	e76f0b05d517f4f77a3dfeae545d533ac13b0340b591f93a3f9a42c18d7267
PAMJA	c7412727328a495263fb55107fea5af27e300652ffa2f4f58ca6db6dc856510c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1983d5ed3b33322759d2edadfed7bc6922f5d8328105a2d9fd8ef10a6c8e9cda
E MËPARSHMJA	101923af159ce0823d0d413bd69edd18677c169e193a2a6ca03b2c82a83874fb
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1983d5ed3b33322759d2edadfed7bc6922f5d8328105a2d9fd8ef10a6c8e9cda>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK SHBA Lufta në Iran Lufta në Ukrainë Volodymyr Zelensky

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Vokshi tregon prapaskenat: Lidhet me konfliktin e Thaçit me Gjermaninë



18 Shtator 2026 | 22:32

I ftuar në "Review" me Greta Topjanën, analisti Indrit Vokshi solli një tjetër interpretim mbi atë që, sipas tij, fshihet pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së. Sipas Vokshit, kjo nuk është thjesht një çështje e lidhur me Serbinë apo Rusinë por lidhet me Gjermaninë, duke argumentuar se ndaj liderëve të UÇK-së ka pasur prej vitesh një përpjekje për t'i larguar nga politika.

"Kjo është faza e fundit e konfliktit të Hashim Thaçit me Shërbimi Federal të Inteligjencës së Gjermanisë dhe me Gjermaninë. Kushdo që thotë se është çështje e Serbisë dhe Rusisë, sepse investitori më i madh për t'i eliminuar këta nga politika është Gjermania. Secila qeveri që ka qenë në Gjermani ka pasur një plan për t'i eliminuar nga politika krerët e UÇK-së. Në shkurt të vitit 2005, BND-ja gjermane nxjerr një raport konfidencial, ku konsideron Hashim Thaçin, Ramush Haradinajn, Fatmir Limajn, Xhavit Halitin si banda kriminale dhe i merr si grup kriminal të Drenicës. Kjo është në raportet gjermane. Në nëntor të vitit 2008 arrestohen tre agjentë të shërbimit sekret gjerman nga Policia e Kosovës. Njëri prej tyre, Andreas Jakel, ju gjetën shënime mbi situatën në Kosovë dhe shënime me emrat e bashkëpunëtorëve të shërbimit sekret gjerman në rrethin e brendshëm të Hashim Thaçit. Kjo del edhe në WikiLeaks, përkthehet gjithashtu në WikiLeaks. Operacioni kishte për qëllim përgjimin e krerëve të lartë të UÇK-së, për të mbledhur informacion për ta dhe për t'i inkriminuar. Dhe çfarë konkludohet më tej? Vjen raporti i Dick Martyt nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, e cila, mund të themi, kontrollohet nga evropianët. Diçka që është harruar këtu: pas raportit të Dick Martyt kemi atë që quhet themelimi i Prokurorisë Speciale, Task Forcës së drejtuar nga Clint Williamson, i cili është prokuror amerikan i emëruar në atë kohë nga Catherine Ashton. Në vitin 2014 ai ka paraqitur një raport ku bën akuzat që janë thënë me datë 16. Pra, është raporti i prokurorit amerikan me mbështetje evropiane. Ky është udhëheqësi i grupit të hetuesve dhe konflikti vazhdon më tej, kur Hashim Thaçi deklaron në vitin 2020 se negociatat duhet të zhvendosen nga Evropa dhe të vazhdojnë në Washington. Pra, Hashim Thaçi është arrestuar nga struktura të forta dhe shumë të fuqishme, sepse i është marrë nga tavolina e Presidentit Trump. Janë struktura të fuqishme të Evropës dhe Dick Marty, në raportin e vet, thotë se ka marrë informacione nga shumë shërbime. Pra, nuk po them komplot, por një plan kundër krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që nga viti 2005, nga krerët e politikës evropiane. Me çfarë sfondi? Në vitin 2005 u lançua projekti i përbashkët Rusi-Gjermani", tha ai.

LAJMI I FUNDIT

10:55 Pak javë para votimit në Izrael, sondazhi nxjerr Eisenkot përpara Netanyahu

10:30 Nafta 219 lekë/litri, benzina 195 lekë, Bordi i Transparencës vendos çmimet tavan

10:18 "Më kërcënuan se do të vrisnin nënën time", Rrëfimi i artistes: Si më urdhëruan të spiunoj dhe të ndihmoj në vrasjen e armikut të Kremlinit

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

10:03 Raporti i rremë i IA-së për pak sa nuk nisi luftë mes SHBA-së dhe Kinës: Operacioni u anulua në momentin e fundit

09:47 Shqipëria i bashkohet NASA-s për eksplorimin e Hënës dhe Marsit, nënshkruan Marrëveshjet Artemis

09:31 Si aleanca mes "mbretit të kokainës" dhe ish-shefit të Gestapos krijoi narkoshtetin e parë në botë

TESTIM

LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | RAJONI | REVIEW

Djali i Jakup Krasniqit: Kur të përfundojë dënimin 25-vjeçar, babai mund të mos jetë gjallë

Djali i Jakup Krasniqit, Altin Krasniqi, tha se babai i tij, 76 vjeç, mund të mos jetë gjallë kur të përfundojë dënimin 25-vjeçar të dhënë...

22:07 | 18/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | RAJONI | REVIEW

Peka: Gjykatat ndërkombëtare, duke përfshirë edhe EULEX-in, e hetuan Kosovën për 24 vite

I ftuar në emisionin Review me Greta Topjana, eksperti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Avenir Peka, ka analizuar ecurinë e hetimit të krimeve të luftës në Kosovë,...

21:31 | 18/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | RAJONI

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, djemtë e Thaçit, Krasniqit dhe Veselit në protestën e Prishtinës (VIDEO)

Në Prishtinë është zhvilluar dita e tretë e protestës pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë për dënimin me gjithsej 81 vite burg të katër...

21:29 | 18/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Punësimi

Follow Euronews on all platforms: